



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 354/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Podujevë, paraqitur për shkak të parregullsive në numërimin e votave, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare në seancën e panelit të mbajtur me 14.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa A.nr 354/2017 e datës 14.06.2017, e parashtruar nga subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Podujevë

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 14.06.2014, nga subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Podujevë në të cilën pretendohet se për shkak të mos përfshirjes së votave të subjektit politik politik LDK-AKR në Formularin e përputhjes së të dhënave dhe Rezultateve 1837E/02D në FPR në emër të koalicionit LDK-AKR nuk figuron asnjë votë. Parashtruesi i ankesës kërkon që të bëhet rinumërimi i votave nga vendvotimi i cekur.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultati preliminar nuk është shpallur nga KQZ-ja dhe se mund të ndryshoj në çdo moment, po ashtu Qendra e Numërimit dhe Rezultateve QNR ende është në fazën e procedimit të materialeve zgjedhore nga Qendrat e Votimit. Andaj rezultati zgjedhor nuk ka marrë formën përfundimtare, në momentin e shpalljes së rezultateve përfundimtare të QNR-së palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme mund të ushtroj ankesën në afatin prej 24 orëve.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të Nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe Nenit 6.4 te Rregullave dhe Procedurave te PZAP-it, ne të cilin përcaktohet se: “Ankesat të cilat janë të palejuar dhe te pasafatshme PZAP-i i hudhë poshtë me vendim”, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A nr. 354/2017 më datën 14.06.2017



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.